

Dr. Shaban HASHANI

REFORMA AGRARE DHE KOLONIZIMI NË RRETHINË E NERODIMES (FERIZAJT) MIDIS DY LUFTAVE BOTËRORE 1918-1941

Një ndër format të cilat u shfrytëzonte regjimi i Mbretërisë Jugosllave për shtypjen, shfrytëzimin dhe shkombëtarizimin e popullsisë shqiptare ishte reforma agrare dhe kolonizimi. Me këtë kolonizim duhej jo vetëm të ndryshohej struktura nacionale e popullatës së Kosovës në dëm të shqiptarëve, por – duke u mbështetur në eksponentët e regjimit të kësaj pjese të popullsisë sllave – nevojitej të sigurohej edhe pozita shoqërore-ekonomike e politike e hegjemonisë serbomadhe. Elementet e kolonizuar duhej të ndikonin njëherit edhe për asimilimin shkallë-shkallë të popullsisë shqiptare. Borgjezia serbe nuk mundi të asimilojë popullsinë shqiptare, si për shkak të kompaktësisë e numrit të saj, ashtu edhe për shkak të rezistencës që i bënte asimilimit të zhvilluar dhe forcuar gjatë robërisë turke.¹

Kolonizimi i Kosovës, e me këtë edhe i Ferizajt, ka filluar menjëherë pas Luftës së Parë Ballkanike. Këtë pohim na e dokumenton edhe Gjorgje Kërstiq kur shkruan: “Çështja e kolonizimit të Serbisë Jugore (Kosovë dhe Maqedoni - Sh.H.) daton nga ai moment kur ushtria ngadhënjyese serbe (ushtria pushtuese - SH.H.) i hoqi prangat shekullore të kësaj toke të robëruar”.² Kolonizimi, siç e shpjegonte Gjorgje Kërstiq, ishte “garancion” i sigurisë publike dhe kafshatë e mirë për stabilizimin e kufijve shtetëror.³

¹ Ali Hadri, Pozita dhe gjendja e Kosovës në Mbretërinë e Jugosllavisë (1918-1941), “Gjurmime albanologjike”, nr.2, Prishtinë, 1968, fq.177.

² Djordje Kristić, Kolonizacija Južne Srbije, Sarajevë, 1928, fq.1.

³ Po aty. Gjorgje Kërstiq ka qenë gjykatës i Gjyqit Suprem e njëherit edhe anëtar i Drejtorisë Kresore Agrare me seli në Shkup. Ky prej majit 1927 deri në gusht 1928 vizitoi viset e “Serbisë Jugore”, gjë që edhe e shkroi librin e përmendur për këtë. (Krahaso: Djordje Krstić, Kolonizacija Južne Srbije, Sarajevë, 1928.).

Kjo është e vërtetë për sa i përket kolonizimit, por ai “harronte” të shtojë se përnjëherë filloi një robëri tjetër për popullsinë shqiptare, së cilës iu vunë prangat e reja. Këtë Kërستیqi nuk e thotë, sepse ai shikon njëanshëm problemin shoqëror dhe politik. Sipas tij qenka dashur që vetëm serbët të çlirohen nga sundimi turk.⁴

Procesi i kolonizimit është kryer nëpërmjet reformës agrare. Reforma agrare, e cila në Kosovë kishte karakter antishqiptar, zbotëj me presione mbi popullsinë vendëse shqiptare, me qëllim që kjo të shpërngulej prej trojeve të saj dhe pastaj pronat e saj t’u ndahen kolonistëve sllavë.⁵

Kolonizimi i Kosovës, e së bashku me këtë edhe i trevës së Ferizajt, ka zgjatur gjatë tërë kohës së ekzistimit të Mbretërisë Jugosllave, përkatësisht prej vitit 1918 deri më 1941. Intensiteti i kolonizimit ka qenë i ndryshëm dhe i cili është varur prej rrethanave ekonomiko-politike në Kosovë dhe në tërë shtetin.⁶

Puna e parë e organizuar për zbatimin e Reformës Agrare pat filluar me themelimin e Drejtorisë Agrare në Shkup, sipas “Urdhresës për konstituimin e Ministrisë për Reformën Agrare” të 12.II.1920 si dhe me formimin e drejtorateve qarkore agrare në të gjitha qendrat e mëdha kolonizuese të “Serbisë Jugore”. Një drejtorat (besueshmëri) i tillë agrar e kishte selinë e vet edhe në Ferizaj. Por zbatimi i plotë i reformës agrare filloi me Urdhresën për kolonizimin e pjesëve jugore të 24.IX.1920.⁷ Kjo njëherit ishte etapa e parë e procesit të kolonizimit. Etapa e dytë e kolonizimit prej vitit 1931 deri më 1941 është kryer në bazë të Ligjit mbi kolonizimin e viseve jugore të 11.VI.1931 dhe ndërrimeve e plotësimeve që u janë bërë këtij Ligji më 5.XII.1933.⁸

Shqiptarëve, të cilëve u “mungonin” dëshmitë se është pronë e tyre, u merrej toka e punuar por ajo u merrej edhe atyre shqiptarëve, që i kishin

⁴ Dr. H. Bajrami, vep.cit., fq.42.

⁵ Po aty, fq.51.

⁶ Dr. Milovan Obradović, Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu (1918-1941), Prishtinë, 1981, fq.130.

⁷ Po aty, fq.149; Dr. H. Bajrami, vep.cit., fq.51.

⁸ Dr. Milivoje Erić, Agrarna reforma u Jugoslaviji 1918-1941, Sarajevë, 1958, fq.392; Dr. Branko Bošković – Dr. A. Apostolov, Stav KPJ prema agrarnoj reformi i kolonizaciji na Kosovu i Metohiji 1919-1941, “Kosova - Kosovo”, nr.1, Prishtinë, 1972, fq.331; Ali Hadri, Rrethanat ekonomike në Kosovë e Metohi në Jugosllavinë e Vjetër, “Përparimi”, nr.1-2, 1965, fq.33.

dëshmitë se janë pronarë të tokës. Organet e pushtetit të atëhershëm shpeshherë bënin presion te shqiptarët, të cilëve u merrej toka që të mos u ankohen organeve më të larta shtetërore për vendimet e tyre, duke iu bërë me dije se organet lokale të pushtetit mund të përdorin maltretime kundër tyre dhe mund të aplikojnë masa të ndryshme represive.⁹

Sa i përketë mungesës së dëshmime për posedimin e tokave te shqiptarët, mendojmë se organet shtetërore këtë gjë e kanë ditur fare mirë. Mungesa e dëshmime të përmendura mund të jetë si rezultat i luftërave të shpeshta që e kanë goditur këtë trevë, sepse në rrebeshin e këtyre luftëtarve një numër i konsiderueshëm i tyre i kishin humbur dëshmitë (fletëposedu-eset). Mungesa e dëshmime nuk ka mund t'i trajtojë shqiptarët si jopronarë të tokave të tyre, por kjo iste një grackë dhe një arsytim gjoja shqiptrët i kanë rrëmbyer më parë ato toka. Këtë po e theksojmë me qëllim që të hudhet poshtë një konkludim i tillë me të cilin është shërbyer borgjezia e Mbretërisë Jugosllave gjatë realizimit të reformës agrare në viset e banuara me shqiptarë.¹⁰

Kolonizimi në fillim kishte hasur në rezistencë edhe të disa deputetëve serbë, të cilët mendonin se me ardhjen e elementit të ri do të humbin përkrahjen për mandate të reja. Borgjezia serbomadhe kishte bërë për vete edhe disa deputet shqiptarë dhe myslimanë të partive politike. Kështu edhe disa deputet të "Xhemietit" e kanë përkrahur në fillim kolonizimin, por, në realitet, siç pohon Gjorgje Kërstiq "kolonizimi duhet të ketë ndikuar në rënien e deputetëve të partisë "Xhemieti".¹¹

Nëpunësit që e kryenin kolonizimin ishin njerëz të korruptuar, të ndjekur prej detyrave të tjera. Këta nëpunës nuk posedonin kualifikime morale dhe nuk gëzonin kurrfarë autoriteti. Vlen të përmendet se personelin teknik e përbënin rusët (bellogardistët – Sh.H.).¹²

Në bazë të të dhënave statistikore mbi kolonizimin, më 1919 në Rrethin e Nerodimes (Ferizajt) ishin kolonizuar 28 familje kolonistësh: në Petroviq (midis Shtimes dhe Godancit – Sh.H.) dhe Zhiti (sot fshat në komunën e Vitisë – Sh.H.) 17, Pleshinë 8, Rashincë 2, Talinofc i

⁹ Dr. Milovan Obradović, Revizija agrarne reforme na Kosovu, "Kosova - Kosovo", nr.3, Prishtinë, 1974, fq.371.

¹⁰ Shaban Hashani, Ferizaj dhe rrethina e tij në Lëvizjen Nacionalçlirimtare 1941-1945, punim magjistrature në dorëshkrim, Ferizaj, 1979, fq.19.

¹¹ Dj. Krstić, Kolonizacija Južne Srbije, fq.49.

¹² Po aty, fq.47.

Muhaxherëve 1 familje.¹³ Në bazë të Ligjit për kolonizim të vitit 1931, në Ferizaj ishte caktuar selia e Komisionit agrar që organizonte reformën agrare dhe kolonizimin për rrethet e Nerodimes, Graçanicës, Gjilanit dhe Kaçanikut.¹⁴

Sipas të dhënave që na jep Dr. Stojan Çupkoviç (mjek) në territorin e Rrethit të Nerodimes (Ferizajt) brenda vjetëve 1918-1935 ishin vendosur 435 familje kolonistësh me 2.364 anëtarë. Po ashtu, këtu kemi të dhëna se sa familje kolonistësh dhe me sa anëtarë janë vendosur në këtë rreth për çdo vit. Tabela do të dukej kështu:¹⁵

Viti i kolonizimit	Numri i familjeve	Numri i anëtarëve të familjeve
1918	5	26
1919	40	174
1920	28	122
1921	21	107
1922	75	403
1923	34	127
1924	23	132
1925	25	139
1926	7	34
1927	13	65
1928	11	77
1929	41	238
1930	19	122
1931	7	35
1932	14	75
1933	12	74
1934	15	108
1935	23	130
Gjithsej:	435	2.364

¹³ Arhiv Jugoslavije (më tutje: AJ), Raport i Komisionit (Drejtoratit) Suprem Agrar në Shkup mbi kolonizimin sipas viteve. (Cituar sipas: Dr. M. Obradoviž, Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu 1918-1941, fq.136.

¹⁴ Dr. M. Obradoviž, Kolonizacija na Kosovu, fq.136.

¹⁵ Dr. Stojan Çupkoviç, Dvadeset godina naše kolonizacije u srezu Nerodimlje na Kosovu, "Glasnik" Centralnog higijenskog zavoda, br.4, Beograd, 1940, fq.520, Tabela 1.

Një ndër rrethet me më shumë koloni në Kosovë llogaritej edhe Rrethi i atëhershëm i Nerodimes. Në këtë rreth deri më 1.I.1928 ishin ngritur 9 koloni dhe 23 vendbanime.¹⁶

Në fillim kolonistët kanë marrë toka djerrina (utrina) të fshatrave, sepse të tilla ka pasur mjaft në territorin e ish-komunave të Rrethit të Nerodimes. Djerrina (utrina) ka pasur sidomos në Komunën e Talinofcit, Kosinës, Babushit, Shtimes, si dhe në rrethinën e afërt të vetë qytezës Feirzaj. Pas vitit 1928 në Rrethin e Nerodimes filluan t'u merren shqiptarëve edhe tokat e punuara. Kështu kanë vepruar edhe komisionet për kufizimin e tokave, e sidomos në territorin e Komunës së Shtimes, ku vetëm pas vitit 1935 u janë marrë fshatarëve 400 hektarë tokë të punueshme.¹⁷ Këtë e vërteton një fragment nga korrespondenca e Mehmet Spahos, e vitit 1938, njërit prej figurave kryesore politike të Bosnjës e të krejt Jugosllavisë së para Luftës së Dytë Botërore. Në letrën drejtuar ministrit të Bujqësisë S.Stankoviç, ai pohonte se "pushteti agrar" në "Serbinë Jugore" vepronte në kundërshtim me dispozitat ligjore, "duke e shpallur tokën në përgjithësi si shtetërore". M.Spaho vinte në dukje se "nga mijëra familje të popullsisë së atjeshme (popullsisë shqiptare – Sh.H.) u morën të gjitha pronat e pundshme, kështu që këta u bënë pa plang e pa strehë... Që të gjendet tokë e cila do të bjerë nën goditjen e reformës agrare, vazhdonte ai mëtej, përfshihen në komplekset tokësore për kolonizim ngastrat e fshatrave të tjera dhe përfshihen jo vetëm sipërfaqet e punuara dhe të papunuara, por edhe shtëpi dhe sheshe. E gjithë kjo tokë, përfundonte Spaho, u shpall për djerrinë dhe pa të drejtë iu rrëmbye popullsisë".¹⁸

Edhe pse kolonizimi në Rrethin e Nerodimes (Ferizajt) nuk ka pasur atë intensitet sikurse në disa vise të tjera të Kosovës, megjithatë mund të thuhet se ky kolonizim e rrezikoi popullsinë autoktone (shqiptare – Sh.H.). Në këtë territor, prej vitit 1919 deri më 1939 janë vendosur 680 familje kolonistësh. Për nevojat e këtyre kolonistëve në territorin e Rrethit të Nerodimes ishte formuar fondi i reformës agrare. Ne posedojmë të dhëna për këto fonde vetëm për vitet 1934 (ishin kufizuar 5.754 hektarë), 1937 (ishin kufizuar 6.079 hektarë tokë) dhe 1939 (ishin kufizuar 37.910 hektarë

¹⁶ Dj. Krstić, Kolonizacija Južne Srbije, fq.6; Hamit Kokolari, Kosova djep i shqiptarizmit, Tiranë, 1943, fq.64.

¹⁷ Nikola Vidačić, Na obalama Nerodimke, Novi Sad, 1967, fq.28-30.

¹⁸ Marenglen Verli, Shpronësimi rrënjësor i fshatarësisë shqiptare në Jugosllavi në vitin 1938, "Studime historike", nr.2, Tiranë, 1991, fq.136.

tokë). Prej këtij fondi agrar deri më 1939 ishin marrur dhe u ishin ndarë kolonistëve sllavë gjithsej 5.723 hektarë tokë dhe çdo familje kishte marrë mesatarisht nga 8,31 hektarë tokë. Tokë u ishte ndarë edhe serbëve dhe malazezëve vendës, ku për çdo familje të tyre u ishte mesatarisht ndarë nga 2,40 hektarë tokë. Minimumi i tokës së ndarë për kolonistët ishte për një familje 5 hektarë kurse maksimumi 10 hektarë tokë.¹⁹

Veprimtaria e autoriteteve agrare kishte marrë një intensitet të madh gjatë muajve maj-qershor 1938. Sipas të dhënave që disponojmë, këtu u sekuestrua pothuajse tërë toka e Komunës së Shtimes, e përbërë nga 10.000 hektarë, nën kulturë dhe pyll. U sekuestruan gjithashtu 90 hektarë tokë të Komunës së Kosinës dhe vetëm njërit nga 14 ankuesit iu njoh e drejta e pronësisë. Kundër vendimit të Komisionit për sekuestrime u ankuar këta pronarë të tokave nga territori i Komunës së Shtimes (Rrethi i Nerodimes): Hajdin Ramadan Shabani prej fshatit Vojnovc, Ali Shaban Aliu prej Vojnovci, Halil Bislim Jashari prej Vojnovci, Shukri Abedin Ismaili prej Vojnovci, Ahmet Abedin Ismaili prej Vojnovci, Shaip Jashari prej Vojnovci, Avdyl Ahmet Asllani prej vojnovci, Ahmet Isuf Hasani prej Vojnovci, A.Fejzullahu prej Vojnovci, Latif Xhemajl Jashari prej Vojnovci, Isuf Ismail Mehmeti prej Vojnovci, Ramadan Meta prej Vojnovci, Ismail Sylejmani prej Vojnovci, Hasan Sadriu prej Vojnovci, Hasan Hysen Abazi nga fshati Davidofc, Rexhep Ali Bekteshi prej Davidofci, Ymer Sylejman Abazi prej Davidofci, Nezir Adem Jusufi prej Davidofci, Sali Zeqiri prej fshatit Muzeçinë, Azis Ymer Sylejmani prej Muzeçine, Hysen Fetahu prej Muzeçine, Hamit Demiri prej Muzeçine, Vesel Sylejmani prej Muzeçine, Halim Zeqiri prej Muzeçine, Shaip Zeka prej fshatit Rashincë, Hamdi Limani prej Rashince, Hysen Zeka prej Rashince, Tahir Veseli prej Rashince, Sefë Haliti prej Raçaku, Mehmet Haliti prej Mollopolci, Harif Sadri Abdiu prej Gjyrkofci, Sherif Rexhep Munishi prej Gjyrkofci, Rashid Munishi prej Gjyrkofci, Zeqir Abdyli prej Gjyrkofci, Maksut Sali Muçe prej Gjyrkofci, Bajram Rushiti prej Rashince, Mirishahe (e shoqja e Sahit Sahitit) prej Rashince, Zejnullah Ymeri prej Rashince, Mustafa Ahmeti prej Rashince, Shukri Haliti prej Rashince, Nazif Rushiti prej Rashince, Ahmet Saliu prej Shtime, Azem Azemi prej Petrove dhe Riza Baliu prej Davidofci. Ndër këto ankesa u quajtën të drejta vetëm 6 prej tyre, por meqë toka kishte

¹⁹ N. Vidačić, Na obalama Nerodimke, fq.33; Dr. Milovan Obradović, Agrama reforma i kolonizacija na Kosovu 1918-1941, fq.150 dhe 161.

hyrë në kompleksin për kolonizim, edhe këtyre iu tha të prisnin derisa t'u jepej tokë në një vend tjetër.²⁰

Se sa i organizuar ka qenë kolonizimi në Rrethin e Nerodimes na tregon fakti se ishin caktuar persona të posaçëm nga disa fshatra të këtij rrethi, detyra e të cilëve ka qenë të japin informata dhe sugjerime gjatë vendosjes së kolonistëve. Persona të tillë për dhënien e informatave kanë qenë: Obren Saviqi nga Fshati i Vjetër, Dushan Vërtikapa nga Babusha, Shpiro Slijepçeviqi nga Ferizaj, Simo Skuliqi nga Pojatishta dhe Ilija Kërtolica nga Gaçka.²¹

Prej 680 familjeve kolonistësh të vendosur në Rrethin e Nerodimes, prejardhja e tyre ishte sa vijon: nga Zhupa e Siriniqit dhe Sredska ishin 150, nga Hercegovina – 250, nga Mali i Zi –70, nga Serbia afro 130 familje. Të tjerët (80 familje) kishin prejardhje nga Bosnja, Lika, Dalmacia dhe Sremi.²² Për prejardhjen e kolonistëve që janë vendosur në Rrethin e Nerodimes (Ferizajt), deri më 1937, sidomos për ata jashtë territorit të Kosovës, të dhëna na jep kolonisti dr. S. Çupkoviqi. Kjo shihet më së miri nga kjo tabelë:²³

Rrethi prej nga janë shpërngulur	Banovina	Numri i familjeve koloniste	Gjithsej familje koloniste
Jabllanicës	Vardarit	105	135
Pçinjës		26	
Kumanovës		1	
Preshevës		1	
Prespës		1	
Gjakovës	Zetës	2	253
Andrijevicës		1	
Maravicës		2	
Podgoricës		5	
Danillovgradit		5	
Nikshiqit		46	
Shavnikut	6		

²⁰ M. Verli, pun.cit., "Studime historike", fq.137,140 dhe 141.

²¹ Dj. Krstić, vep.cit., fq.103.

²² N. Vidačić, Na obalama Nerodimke, fq.34.

²³ Dr. S. Čupković, pun.cit., fq.524, Tabela 3.

Milleshevës		1	
Cetinjës		3	
Bokës së Kotorit		1	
Nevesinjës		2	
Foçës		1	
Stollcit		7	
Lubinjës		9	
Trebinjës		5	
Gackos		55	
Bileqes		103	
Nishit		1	
Timokut		1	
Kopaonikut		4	
Kosanicës		3	
Jagodinës	Moravës	1	
Dobriçit		1	
Prokuples		12	
Zhupës		1	
Polanicës		1	25
Kluçit		2	
Bihaqit	Vërbasit	2	4
Zemunit	Danubit	1	1
Libanjit		4	
Brinjës		1	
Sinjit	Kroacisë	1	
Shibenikut		1	
Kostajnicës		1	8
Sllovenë - emigrantë nga Italia			8
Gjithsej			435

Të dhëna edhe më të hollsishe, me emra dhe mbiemra, mbi prejardhjen e kolonistëve (sigurisht të kryefamiljarëve – Sh.H.) të vendosur

në Rrethin e Nerodimes prej vitit 1918 deri më 1941, na jep në veprën e tij dr. Millovan Obradoviç.²⁴

Kolonistët në të shumtën e rasteve janë vendosur nëpër fshatra, të cilat ekzistonin edhe më parë, ndërsa disa i kanë themeluar vetë ata. Numri më i madh i kolonistëve është vendosur në Komunën e atëhershme të Talinofcit: Fshati i Vjetër, Sojevë, Bibaj, Pojatishtë, Sazli, Softaj, Gërbollë dhe Papaz. Prej këtyre fshatrave si fshat i ri është themeluar Gërbolla gjatë viteve 1929 deri 1933. Ky fshat është ngritur në vendkullosat e fshatit Rahovicë. Në Komunën e Babushit kolonistët u vendosën në këto fshatra: Babushi i Muhaxherëve, Marefc, Gadime, Cërmillë dhe Mirash. Në Komunën e Kosinës ata u vendosën në Prelez (të Jerlive – Sh.H.), Muhofc, Slivovë, Koshare. Në Komunën e Shtimes kolonistët u vendosën në Rashincë, Petroviq (koloni e re – Sh.H.), Muzeçinë dhe Gllavicë (midis fshatit Rashnicë dhe Koshare). Në territorin e Komunës së Gaçkës ata u vendosën në Gërlicë, Varosh, Gaçkë dhe Greme. Kolonistët u vendosën edhe në fshatrat e Komunës së Nerodimes: në Pleshinë, Doganaj dhe disa shtëpi afër kazermave të ushtrisë dhe në rrethinën e afërt të vetë qytetës së Ferizajt siç është Nukudimi, vendi i quajtur Penda (afër udhëkryqit Shkup-Gjilan-Prishtinë – Sh.H.) etj.²⁵

Sipas një dokumenti të publikuar nga dr. Jusuf Osmani, në Rrethin e Nerodimes ishte vendosur nëpër fshatra ky numër familjesh koloniste: Babushi 3, Rubofci 4, Prelezi i Mihaxherëve 7, Marefci 6, Gadimja e Epërme 2, Rahoveci 13, Mirashi 16, Babushi i Vjetër 12, Rashinca 11, Shtimja 2, Petroviqi 15, Bregu i Zi (Carrabregu) 2, Gjyrkofci 5, Komogllava 5, Gremja 1, Varoshi 1, Zaskoku 3, Pleshina 9, Softaj 1, Sazlia 5, Talinofci i Muhaxherëve 30, Fshati i Vjetër 14, Bibaj 3, Sojeva 4, Pojatishta 22, Papazi 23, Ferizaj 18, Prelezi i Jerlive 30, Kosharja 7, Muhofci 8, Lloshkobarja 12, Slivova 1 dhe Tërni 2 familje.²⁶

Nga dokumenti shihet se këto të dhëna nuk i përgjigjen numrit real të familjeve koloniste të vendosura në territorin e Rrethit të Nerodimes midis dy luftërave botërore. Këtu nuk figurojnë fare disa fshatra ku janë vendosur

²⁴ Dr. M. Obradović, Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu 1918-1941, fq.243-248.

²⁵ N. Vidačić, Na obalama Nerodimke, fq.35: Mladen T. Milić, Kosovsko selo Grbole od nastanka do nestanka, Prishtinë, 1984, fq.13. Kolonistët kishin themeluar edhe fshatin Tankosiq, i cili atëherë i takonte Rrethit të Gjilanit.

²⁶ Dr. Jusuf Osmani, Regjistrimi i vendbanimeve ku janë vendosur kolonët në territorin e Kosovës deri më 8.IV.1940, "Bujku", 8.VI.1996, Prishtinë, fq.12.

kolonistët. Dokumenti nuk ofron as gjysmën e numrit real të familjeve koloniste (680 sosh - Sh.H.).

Kolonizimin, e posaçërisht mënyrën e ndarjes së tokave, e shfrytëzonin edhe politikanët e partive politike. Për t'ia siguruar vetes votat në zgjedhje, disa u premtonin toka votuesve, ndërsa të tjerët u premtonin bujqëve shqiptarë në këtë trevë se nuk do t'u merrej toka. Në këtë drejtim prinin kandidatët e Partisë Radikale, të Bashkësisë Radikale (JRZ), ndërsa në prag të Luftës së Dytë Botërore, e sidomos prej vitit 1935 deri më 1938 me këtë çështje janë shërbyer edhe disa politikanë të Opozitës së Bashkuar.

Gërshetimin e marrëdhënieve të tilla mund ta ilustrojë formimi i të ashtuquajturit Kompleksi i Porodimes, i cili në vitin 1939 iu ishte ndarë kolonistëve serbomalazezë. Ky kompleks shtrihej midis fshatrave Shtime dhe Koshare dhe ishte formuar në atë mënyrë ku prej fshatarëve shqiptarë ishte marrë toka e punuar. Ky kompleks tokash nuk u nda menjëherë, sepse u lajmërua rezistenca e madhe nga të gjitha anët. Së pari kundërshtuan fshatarët shqiptarë, kurse pastaj në lidhje me këtë çështje filluan të përcaktohen edhe partitë politike, sepse disa ishin për e disa kundër ndarjes së këtyre tokave. Kështu, si "shpëtimtar" i fshatarëve shqiptarë u paraqit edhe naçallniku i atëhershëm i Rrethit të Nerodimes, Zeçeviçi, i cili vepronte sipas urdhrave të udhëheqësisë së Bashkësisë Radikale Jugosllave (JRZ).²⁷

Ministri i atëhershëm i bujqësisë, dr. Branko Çubrilloviq, kërkoi që kompleksi Porodime të ndahet menjëherë. Për këtë çështje, ai kishte dërguar në Ferizaj të deleguarin e vet personal Bogosav Shekullarcin. Ky i deleguar ua ndau menjëherë këtë kompleks tokash kolonistëve. Por, derisa B.Shekullarci udhëtonte për Beograd, në të njëjtin tren udhëtonin edhe nja 70 shqiptarë të Komunës së Kosinës dhe Shtimes, të cilët shkonin për t'u ankuar. Ky delegacion i shqiptarëve, më parë ishte drejtuar në Ministrinë e Ushtrisë, ku i kishte pranuar gjenerali Mariq, ministër i ushtrisë. Mariqi menjëherë për këtë e kishte lajmëruar Dragisha Cvetkoviqin, kryetarin e qeverisë, ndërsa ky i fundit e kishte lajmëruar Dr.Branko Çubrilloviqin, ministrin e bujqësisë. Ky i fundit nuk e mori parasysht këtë delegacion dhe kategorikisht kërkoi që kompleksi i Porodimes t'u ndahet kolonistëve. Kjo

²⁷ N. Vidačić, Na obalama Nerodimke, fq.31-32.

ishte njëherit ndarja e fundit e tokave për kolonistë në territorin e Rrethit të Nerodimes deri në Luftën e Dytë Botërore.²⁸

Shpeshherë kolonistët ua venin syrin pronës të ndonjë shqiptari dhe kërkonin me këmbëngulje, edhe pse atyre u ofrohej tokë diku tjetër, që të vendoseshin aty. Rast tipik i këtyre sjelljeve të paskrupullta në Ferizaj ishte rasti i kolonistit nga Uzhica, Josif Çirkoviçi. Ky më 1928 i ishte drejtuar me lutje Oborrit Mbretëror që t'i ndahen 5 hektarë tokë në afërsi të Ferizajt. Me aktin nr.371/1929 këtij kolonisti i ishte lëshuar vendimi për këta 5 hektarë. Por, ky kishte refuzuar marrjen e tokës me arsyetim se kërkonte së pari tokën e Hasan Salihut nga Ferizaj në madhësi prej 3 hektarësh. Kur gjatë vitit 1928 iu ishin ndarë kolonistëve hercegovas tokat e fshatrave Papaz dhe Rahovicë, Josif Çirkoviçi kishte shkuar me familje në Uzhicë.²⁹ Më 18 janar 1929 J.Çirkoviçi përsëri i drejtohet Oborrit Mbretëror me kërkesë që t'i ndahet toka prej 3 hektarësh e Hasan Salihut. Kësaj radhe ky e akuzonte Hasanin se nuk ka qenë lojal ndaj ushtrisë serbe gjatë Luftës së Parë Botërore, kurse veten e lavdëronte dhe si luftëtar ishte, por që ishte lënë pas dore nga ana e pushtetit të atëhershëm.³⁰

Për shkak të skamjes së madhe, disa fshatarë shqiptarë kishin hyrë borxh nëpër entet kreditore (banka) dhe si peng kishin lënë pasurinë e patundshme deri kur të kthejnë borxhin. Por mundësia për ta kthyer borxhin ishte minimale, prandaj pasurinë e patundshme nuk mund ta kthenin dhe kështu binin në varfëri të thellë. Kjo i ndodhi edhe Arif Aliut nga fshati Greme e Ferizajt, të cilit Banka Shtetërore Hipotekare ia kishte marrë 5 hektarë tokë si kompenzim për moskthimin e borxhit që Arifi e kishte marrë nga kjo bankë. Për të dalë nga kriza me 21 anëtarët e familjes së vet, ky, më 29.XII.1932, i ishte drejtuar me lutje Mbretit Aleksandër I Karagjorgjeviqit që t'i jepet diku tokë së paku edhe kodrinore, të cilën do ta shndërronte në tokë buke.³¹ Ankesa e tij ishte shqyrtuar dhe ishte vendosur negativisht me

²⁸ Po aty, fq.32. Shënimet mbi ndarjen e këtij kompleksi i kishte dhënë Bogosav Shekullarac nga Beogradi, nëpunës i atëhershëm dhe i deleguar i Ministrisë së Bujqësisë (Krahaso: N. Vidačić, Na obalama Nerodimke, fq.32, fusnota 26.).

²⁹ Arkivi i Kosovës (më tutje: AK), Fondi "Dvor" (Oborri Mbretëror) 1919-1941, Sig.I/3-1, mikrofilm, Raport i Ministrisë për Reformë Agrare, nr.12086 dt.22.III.1929, dërguar Zyrës Mbretërore në Beograd.

³⁰ AK, Fondi "Dvor", Sig.I/3-1, Kërkesa e Josif Çirkoviqit drejtuar Oborrit Mbretëror më 18.I.1929.

³¹ AK, Fondi "Dvor", Sig.I/3-1, Ankesa e Arif Aliut nga fshati Greme e Ferizajt dërguar Mbretit Aleksandër I Karagjorgjeviqit më 29.XII.1932.

motivacion se Arifi nuk llogaritej si i interesuar në bazë të Ligjit për kolonizimin e Viseve Jugore të 11.VI.1931.³²

Se malverzimet e kolonistëve nuk kishin kufi tregon edhe rasti i familjes Xhudoviq. Kjo familje koloniste gjatë viteve 1922 dhe 1923 kishte shëtitur dhe kërkuar tokë prej Shkupi deri në Nerodime të Ferizajt, edhe pse nuk kishte të bëjë me bujqësi. Pas shumë bredhjeve zgjedhëse, kjo familje u vendos në Ferizaj ku menjëherë organet agrare i dhanë tokë, kurse shqiptarët të shtyrë nga dhuna ia ndërtuan shtëpinë.³³

Kolonizimi edhe mëtej thelloi ndarjen e urrejtjes e sidomos midis kolonistëve dhe shqiptarëve. Kolonistët, në tokat e marra nga shqiptarët e ndjenin veten si në tokën e stërgjyshërve të tyre. Pos kësaj, këta kolonistë i merrnin me mëditje të mjerueshme po ata shqiptarë të cilëve ua kishin marrë edhe tokën. Kolonistët e tillë kanë mbjellë urrejtje në vete, ku disa prej tyre, për qëndrimet e veta brutale ndaj shqiptarëve gjatë Mbretërisë Jugosllave e kanë paguar edhe me kokë, sidomos gjatë Luftës së Dytë Botërore.³⁴

Qëllimin e reformës agrare dhe të kolonizimit midis dy Luftërave Botërore e gjejmë edhe në dokumentet e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare 1941-1945. Në lidhje me këtë, në Rezolutën e Konferencës së Parë të Këshillit Nacionalçlirimtar për Kosovë e Rrafsh të Dukgjinis shkruan:

“Kulmi i shfrytëzimit ekonomik ka qenë reforma agrare që kishte për qëllim: të mprehë urrejtjen shoviniste në mes të popullit shqiptar, serb e malazez, të varfërojë shqiptarët në një shkallë të tillë sa të detyrohen të shpërngulen”.³⁵

Reforma agrare dhe kolonizimi u bë një ndër armët më të fuqishme për procesin e shpërnguljes dhe dëbimit të shqiptarëve nga trojet e veta etnike. Procesi i shpërnguljes me dhunë të shqiptarëve kishte filluar më 1912 dhe kishte vazhduar gjatë periudhës në mes dy luftërave botërore.

³² AK, Fondi “Dvor”, Zyra Mbretërore, Nr.903/VI, dt.5.1.1933.

³³ Dr. H. Bajrami, vep.cit., fq.76.

³⁴ N. Vidačić, Na obalama Nerodimke, fq.31; Shaban Hashani, Ferizaji dhe rrethina e tij në Lëvizjen Nacionalçlirimtare 1941-1945, punim magjistrature në dorëshkrim, Ferizaj, 1979, fq.21.

³⁵ Këshilli Populluer i Kosovë-Metohisë 1943-1953, Prishtinë, 1955, fq.8; Dr. A. Hadri, Këshillat Nacionalçlirimtare në Kosovë, Prishtinë, 1974, fq.104.

Dr. Shaban HASHANI

AGRARIAN REFORM AND COLONISATION IN THE REGION OF NERODIME
BETWEEN THE TWO WORLD WARS 1918-1941

Summary

One of the forms that were used by the Yugoslav Kingdom regime during the period between 1918 and 1941 for exerting pressure, exploitation and denationalization of the Albanian population were the agrarian reform and colonization of Albanian ethnic areas. They took the land from Albanians and gave it to Serbian and Montenegrin colonists who the Serbian regime brought from Serbia, Montenegro, Bosnia, Lika, Dalmatia, Srem, Banat, from the regions of Siriniq and Sredska, etc. This pressure was exerted upon the Albanian autochthonous population in the region of Ferizaj, which was called the District of Nerodime, with its seat in Ferizaj.

Until 1935, in the territory of Nerodime 435 families colonists of Serbian-Montenegrin origin with 2,364 members were placed, and during the period between 1918 and 1941 in this region 680 colonist families were brought, who were given a surface of 5,723 hectares of land which had been taken from Albanians. The latter addressed complaints to high state administrative bodies, but in vain.

Colonization and the agrarian reform had deepened hatred between the colonists and Albanians.

